



EKA

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR
ENEIDA RAHMANI
NR LICENCE 158 date 19/05/2006



**KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE
TIRANË**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

**Mbi Auditimin Ligjor të Fondeve të Përftuara
dhe të Shpenzuara Gjatë vitit kalendarik 2011
nga
“Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
(P.A.A)”**

**EKSPERTE KONTABELË E REGJISTRUAR
ENEIDA RAHMANI**





EKA

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

ENEIDA RAHMANI

NR LICENCE 158 date 19/05/2006

RAPORT

Për : KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Ne kemi kryer procedurat e rena dakort me ju ne kontraten e lidhur ndermjet paleve ne date 24.05.2012 qe do te pershkruhen me poshte, lidhur me fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011 nga "Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise" (P.A.A).

Angazhimi yne u krye ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit dhe ne veçanti me SNA 4400 te zbatueshem ne angazhimet per procedurat e rena dakort.

Procedurat u kryen vetem per t'ju ndihmuar juve qe te percaktoni fondet e perftuara dhe te shpenzuara gjate vitit 2011 nga " Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise" (P.A.A) te cilat jane permbledhur me poshte :

1.Ne morem nga KQZ Vendimin Nr. 6 date 04.04.2012 per kryerjen e auditimit ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara ne vitin 2011 nga " Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise (P.A.A) ".

2.Ne morem nga KQZ numrin dhe daten e vendimit te gjykates me te cilen ishte rregjistruar " Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise"(P.A.A) .

3.Në baze te vendimit Nr. 6 date 04.04.2012 te KQZ ne ju drejtuam Gjykates se Rrethit Tirane me kerkese per te na pajisur me kopje te vendimit te rregjistrimit te " Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise" (P.A.A) per te mundesuar identifikimin e selise qendrore dhe drejtuesve te saj ne menyre qe te arrinim ne realizimin e objektit te kontrates se auditimit date 24.05.2012.

4.Ne shkuam ne seline qendrore te " Partia Agrare Ambjentaliste e Shqiperise" (P.A.A) te deklaruar ne vendimin e gjykates Tirane ne adresen Rruga "BUDI ", Nr. 6, per te kontaktuar me Organet drejtuese te partise per realizimin e auditimit ligjor te fondeve te saj.





EKA

EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR

ENEIDA RAHMANI

NR LICENCE 158 date 19/05/2006

5. Ne u interesuam dhe pyetem fqinjët që ndodheshin në të dy krahet e adresës së selisë qendrore të partisë në Rrugë "BUDI", Nr. 6., Tiranë për të na ndihmuar në dënimin e informacioneve për gjetjen e kontakteve (telefon fiks ose celular, adresë banim shtëpie ose e-mail) të drejtuesve të partisë dhe në veçanti të kryetarit të saj.

6. Ne hartuam : **KËRKESË PËR DËRGIM TË TË DHËNASH**

**Për : PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPERISE PAA
RRUGA BUDI NR 6 ,TIRANE**

Lënda: Kërkesë për dërgim të të dhënash

Dhe këto kërkesë në datën 20/06/2012 me shërbimin postar të Postës Shqiptare sh.a me Kod Bar 135101 (fotokopje bashkangjitur raportit) e dërguam pranë "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" (P.A.A).

7. Ne nuk mëmë konfirmim dhe nuk mëmë mundem të gjenim personat për të mundësuar realizimin e objektit të kontratës së auditimit.

Si konkluzion për shkak se procedurat e mesipërme nuk përbejnë auditim dhe as rishikim të bërë në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit në nuk mund të shprehim asnjë opinion për fondet e përftuara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2011 nga "'Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" (P.A.A).

Nëse do të kishim kryer procedura shtese ose nëse do të kishim bërë auditim të Pasqyrave Financiare të vitit 2011 nga "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" (P.A.A), (Fondeve të përftuara dhe të shpenzuara) në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit çështje të tjera do të kishin tërhequr vëmendjen tonë për të cilat do t'ju kishim raportuar.

Raporti ynë shërben vetëm për qëllimin e përshtruar në paragrafin e përë të tij dhe vetëm për t'ju informuar juve.

Ky raport nuk mund të përdoret për qëllim tjetër dhe as t'ju shpërndahet përleve të treta.

Ky raport lidhet vetëm me gjetjet e raportuara me sipër dhe nuk shtrihet mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2011 (Fondet e përftuara dhe të shpenzuara) të "Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë" (P.A.A).

EKSPERTE KONTABELË E REGJISTRUAR

ENEIDA RAHMANI

